

Dr. Musli Vërbani

Tregime prej haditheve të Muhamedit a.s.

(365 tregime për fëmijën tuaj brenda 12 muajve të vitit)

Kaçanik, 2020

Titulli:

Tregime prej haditheve të Muhamedit a.s.


Autor:

Dr. Musli Vërbani

Korrektues:

Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori



Tregime prej haditheve të Muhamedit a.s.



Një ditë i dërguari i Allahut rrinte me shokë.
 Shfaqet një njeri me tesha të bardha.
 Me flokë të zeza.
 Në të nuk vëreheshin shenja udhëtimi.
 Asnjëri prej sehaveve nuk e njohte.
 Ulet pranë të dërguarit a.s.
 I mbështet gjunjët me gjunjët e tij.
 I vendos duart mbi kofshën e tij.
 E pyeti Muhamedin a.s.:
 - O Muhamed, më thuaj ç'është Islami?

Muhamedi a.s. iu përgjigj:
 Islami është:

- Të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij,
- të falësh namaz,
- të japësh zekat,
- të agjërosh ramazan,
- të kryesh haxh në Qabe, po pate mundësi.

Ai njeriu tha:
 - Fole drejt.

Sehabet çuditën se si njëherë po e pyeste e mandej po ia vërtetonte përgjigjen.
 Ai njeriu shkoi, e sehabet mbetën të habitur.
 Muhamedi a.s. parashitroi pyetje:
 - O Umer a e njohë atë që po më pyeste?
 Umeri i përgjigjet: - Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më së miri.

Muhamedi a.s. tha:
 - **Ai ishte Xhibrili,**
Kishte ardhur për të ua mësuar fenë besimtarëve.

Një ditë i dërguari i Allahut rrinte me shokë.

Shfaqet një njeri me tesha të bardha.

Me flokë të zeza.

Në të nuk vëreheshin shenja udhëtimi.

Asnjëri prej sehaveve nuk e njohte.

Ulet pranë të dërguarit a.s.

I mbështet gjunjët me gjunjët e tij.

I vendos duart mbi kofshën e tij.

E pyeti Muhamedin a.s.:

- O Muhamed, më thuaj ç'është Imani?

Muhamedi iu përgjigj:

Imani është:

- të besosh në Zotin,
- në Melekët,
- në librat,
- në të dërguarit e Tij,
- në ditën e fundit dhe në caktimin e Tij për të mirën e për të keqen.

Njeriu tha:

- Fole drejt.

Sehabet çuditën se si njëherë po e pyeste e mandej po ia vërtetonte përgjigjen.

Ai njeri shkoi, e sehabet mbetën të habitur.

Muhamedi a.s. parashitroi pyetje:

- O Umer a e njohë atë që po më pyeste?

Umeri i përgjigjet:

- Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më së miri.

Muhamedi a.s. tha:

- **Ai ishte Xhibrili,**

kishte ardhur për t'ua mësuar fenë besimtarëve.

Një ditë, i dërguari i Allahut rrinte me shokë.
 Shfaqet një njeri me tesha të bardha.
 Me flokë të zeza.
 Në të nuk vëreheshin shenja udhëtimi.
 Asnjëri prej sehaveve nuk e njihte.
 Ulet pranë të dërguarit a.s.
 I mbështet gjunjët me gjunjët e tij.
 I vendos duart mbi kofshët e tij.
 E pyeti Muhamedin a.s.:
 - O Muhamed, më thuaj ç'është Ihsani (Mirësia)?

Muhamedi a.s. iu përgjigj:

- Ta adhurosh Zotin sikur ta shihje, sepse, ndonëse ti nuk e sheh, Ai të sheh ty.

E pyeti gjithashtu:

- Ç'është çasti i Kijametit?

Muhamedi a.s. iu përgjigj:

- Për këtë ai që po pyetet nuk di më shumë se ai që po pyet.

Ai njeriu, pas kësaj përgjigjeje, pyeti:

- Atëherë më trego për shenjat e Kijametit.

Muhamedi a.s. iu përgjigj:

- Kur robëreshës fëmija t'i bëhet zonjushë. Kur të shihen barinjtë këmbëzbathur, të zhveshur e të mjerë, teksa garojnë pas ndërtimit të godinave të mëdha.

Sehabet çuditen se si njëherë po e pyeste e mandej po ia vërtetonte përgjigjen.

Ai njeri shkoi, e sehabet mbetën të habitur.

Muhamedi a.s. parashitroi pyetje:

- O Umer a e njohe atë që po më pyeste.

Umeri i përgjigjet: - Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më së miri.

Muhamedi a.s. tha:

- **Ai ishte Xhibrili.**

Kishte ardhur për t'ua mësuar fenë besimtarëve".

Meleku dhe i zgjebosuri

Tre njerëz të një vendi, Allahu xh.sh. dëshiroi t'i sprovtojë:
Njëri e kishte zgjebën,
i dyti ishte pa flokë (tullac) dhe
i treti i verbër.

Që të tre kishin të meta, që të tre ishin të vetmuar, nuk u ndihmonte askush, por vetëm largoheshin prej tyre për shkak të sëmundjeve neveritëse të tyre dhe për shkak të papastërtisë së tyre.
Allahu dërgoi një melek te ata për t'i sprovuar, duke u dhënë atyre pasuri dhe duke ua larguar sëmundjet.

Meleku shkoi te njeriu i parë i cili e kishte sëmundjen e zgjebes:

- Çka dëshiron? - i tha.

- Nuk dua asgjë, pos të më shërojë Zoti nga kjo sëmundje dhe të kem pasuri sa për ekzistencë – tha i zgjebosuri.

Meleku e preki dhe ai u shërua nga zgjebja, pastaj i tha se Allahu ia ka dhënë këto dy dele dhe prej tyre do të pasurohet.

Kaluan shumë vite e ky u forcua dhe u pasurua, pasi që Allahu i Madhëruar i kishte frymëzuar delet të shumohen.

Pas atyre viteve të shumta, Allahu e dërgoi melekun dhe e urdhëroi që të shndërrohet në formën e një njeriu të varfër e me rroba të vjetra, që t'i sprovtojë ata se a janë bamirës, a e falënderojnë Zotin dhe a u ndihmojnë nevojtarëve.

Në atë formë, si i varfër, meleku kërkoi ndihmë prej të zgjebosurit, e i tha: - Jam udhëtar, kam nevojë për ndihmë, më jep diç prej asaj që të ka dhënë Allahu! Ai e refuzoi dhe filloi t'i bërtas, duke e qortuar.

Në atë moment, befasisht, prej formës së njeriut të varfër u shndërrua në formën e melekut të vërtetë dhe i tha:

Pasi ti nuk i njeh të mirat e Allahut dhe njerëzit nuk kanë dobi prej teje, kthehu zgjebkan siç ishe më parë. Dhe menjëherë iu kthye sëmundja e mëparshme.

Meleku dhe tullaci

Tre njerëz të një vendi, Allahu xh.sh. dëshiroi t'i sprovtojë:

Njëri e kishte zgjebën,
i dyti ishte pa flokë (tullac) dhe
i treti i verbër.

Që të tre kishin të meta.

Që të tre ishin të vetmuar.

Nuk u ndihmonte askush, por vetëm largoheshin prej tyre për shkak të sëmundjeve
neveritëse të tyre dhe për shkak të papastërtisë së tyre.

Allahu dërgoi një melek te ata për t'i sprovuar, duke u dhënë atyre pasuri dhe duke ua
larguar sëmundjet.

Kështu pra, meleku shkoi te tullaci dhe i tha:

- Çka dëshiron?

Njeriu pa flokë, tullaci, i tha:

- Nuk dua asgjë tjetër, pos të më shërojë Zoti nga kjo sëmundje dhe të kem pasuri sa për
ekzistencë.

Meleku e preki dhe ai u shërua nga sëmundja, pastaj i tha se Allahu ia ka dhënë këto dy
dele dhe prej tyre do të pasurohet.

Pas një kohe, meleku shkoi dhe e vizitoi tullacin, por shkoi në formën e një të varfri dhe
kërkoi ndihmë prej tij.

Ai u tregua shumë koprrac. Filloi t'i bërtas, ta ofendojë dhe ta largojë me forcë.

Meleku me shpejtësi u shndërrua në formën e vërtetë dhe i tha:

- Kthehu në sëmundjen e mëparshme, pa flokë (tullac).

Me urdhrin e Allahut u sëmur.

Ai filloi të qajë dhe u pendua, por pendimi i tij nuk pati efekt.

Meleku dhe i verbëri

Tre njerëz të një vendi, Allahu xh.sh. dëshiroi t'i sprovtojë:

Njëri e kishte zgjebën,
i dyti ishte pa flokë (tullac) dhe
i treti i verbër.

Që të tre kishin të meta,
që të tre ishin të vetmuar.

Nuk u ndihmonte askush, por vetëm largoheshin prej tyre për shkak të sëmundjeve
neveritëse të tyre dhe për shkak të papastërtisë së tyre.

Allahu dërgoi një melek te ata për t'i sprovuar, duke u dhënë atyre pasuri dhe duke ua
larguar sëmundjet.

Meleku shkoi te i verbëri dhe i tha:

- Çka dëshiron?

I verbëri tha:

- Nuk dua asgjë tjetër, pos të më kthejë Zoti shikimin dhe të kem pasuri sa për
ekzistencë.

Meleku e preku dhe atij i erdhi shikimi, pastaj i tha se Allahu ia ka dhënë këto dy dele
dhe prej tyre do të pasurohet.

Pas një kohe shkoi meleku prapë për ta sprovuar. Kur shkoi te ai, u paraqit si i varfër, i
gjorë dhe me rroba të vjetra, dhe i tha:

- A keni diçka të më ushqeni se jam i uritur?

Ai me zemërgjerësi i tha:

- O vëlla, ti je i varfër dhe nevojtar.

Por tërë kjo pasuri është begati prej Allahut, merr sa të duash dhe sa të kesh nevojë,
vetëm se për këtë falënderojë Allahun, e jo mua. Meleku prej të varfrit u shndërrua në
formën e vërtetë e tha:

- **Ti je bamirës, falënderues dhe i dobishëm për shoqërinë, për këtë arsye Allahu do ta
shtojë pasurinë dhe do të të japë shëndet të fortë përgjithmonë.**

Foshnja në djep

Një foshnje ishte duke thithur gji te nëna e vet.
Kalon aty pari një kalorës hipur në një deve të shtrenjtë e të bukur.

Nëna e tij tha:

- **O Allahu im, bëje djalin tim sikurse ky!**

Fëmija e la gjirin, u kthye nga njeriu, e shikoi dhe tha:

- **O Allahu im, mos më bën si ai!**

Pastaj u kthye nga gjiri dhe vazhdoi të thithë.

Pastaj njerëzit kaluan me një robëreshë duke e rrahur dhe i thoshin:

- Ke bërë pandershmëri, ke vjedhur.

Kurse ajo thoshte:

- **HasbijAllahu ve ni'mel-vekil.**

(Allahu më mjafton për gjithçka dhe Ai është mbrojtësi më i mirë)

Nëna e foshnjës tha: - **O Allahu im, mos e bëj djalin tim si kjo.**

Foshnja e la thithjen dhe shikoi nga ajo e tha:

- **O Allahu im, më bëj mua si ajo.**

(Foshnja) është arsyetuar:

- **Ai njeri ishte tiran, andaj dhe kam thënë, o Allahu im, mos më bëj si ai! ndërsa**

- **ajo për të cilën thoshin se ka bërë pandershmëri, ajo nuk ka bërë, kanë thënë ka vjedhur, e ajo nuk ka vjedhur, thashë: O Allahu im, më bëj mua si ajo.**

Floktarja e bijës së faraunit

Na ishte një shërbëtore e vajzës së faraonit.

Ajo një ditë duke ia krehur flokët bijës së Faraonit i ra krehri në tokë.

Ajo duke e marrë atë tha: - **Bismilah (me emrin e Allahut).**

Vajza tha:

- Në emër të babit tim a?

Ajo tha:

- Jo, babi yt nuk është zot. Por Zot është Krijuesi im, i babit tënd dhe Zot i gjithësisë.

Vajza tha:

- Unë dua ta lajmëroj babin tim për këtë që ti po thua.

Floktarja tha:

- Bëja me dije.

Ajo e lajmëroi faraonin.

Firauni e thirri shërbëtoren dhe i tha:

- A është e vërtetë se ti beson në një tjetër zot pos meje?

Ajo tha:

- Po, Zot është vetëm Allahu. Ai është Zoti im, i yti dhe i gjithë botëve.

Faraoni porositi të ndizet një zjarr, e pastaj i tha asaj:

- Shko merri fëmijët e tu dhe sjelli këtu.

E ajo i solli fëmijët.

Faraoni tha:

- Tërhiq nga besimi në tjetër zot.

Ajo tha:

- Jo kuurrë.

Ai tha:

- Hidhjani fëmijën në zjarr.

E hodhën të parin, pastaj të dytin.

Kur i tha që ta hedhin edhe atë që e kishte në krah, atëherë ajo u ndal.

Në atë moment fëmija çoi kokën dhe tha:

- **Nënë mos u tërhiq ngase nuk ka zot tjetër pos Allahut.**

Atëherë ajo u hodh në zjarr me gjithë foshnjën e saj.

Nga tymi dhe shkrumbi i tyre u parfumuan qiejt.

Ai parfum edhe sot qëndron lartë në qiej.

Pendimi pas 100 vrasjeve

Një njeri kishte vrarë nëntëdhjetë e nëntë vetë.
Ka pyetur për njeriun më të dijshtëm në botë.
Atë e udhëzuan te një njeri i devotshëm.

Shkon te njeriu i devotshëm e i thotë se ka vrarë 99 veta, andaj a ka për të pendim?
Njeriu i devotshëm i thotë se për të nuk ka teube.
Ky e vret edhe njeriun e devotshëm dhe me të i plotëson njëqind të vrarët.

Pastaj vazhdon të kërkojë njeriun më të ditur në botë, e udhëzuan te një dijetar.
Ky, pasi e gjen, i tregon se ka vrarë 100 njerëz dhe e pyet edhe këtë se a ka për të pendim.
Dijetari i tha se edhe për të ka teube: - Po! Por është shumë larg dhe vështirë.

Vrasësi e pyeti:

- Sa është largësia mes meje dhe teubes?

Dijetari i tha:

- Shko në atë vend dhe në atë vend, aty banojnë njerëz të cilët e adhurojnë Allahun, edhe ti adhuroje Allahun me ta dhe mos u kthe kurrë në vendin tënd, sepse është vend i keq.

Njeriu u nis për në vendin e adhurimit të Allahut dhe kur arriti në gjysmë të rrugës i erdhi vdekja.

Atëherë lindi grindja në mes Melekëve të mëshirës dhe Melekëve të dënimit.

Melekët e mëshirës thanë:

- Ai deri këtu ka ardhur i penduar për mëkatet me zemër të drejtuar nga Allahu i Madhërishëm.

Melekët e dënimit thanë:

- Asnjëherë më parë nuk ka bërë mirë.

Atëherë këtyre Melekëve u vjen një Melek tjetër në formë të njeriut e këta e morën për gjykatës, që të gjykojë se cilët kanë të drejtë.

Ky u thotë:

- Matni në mes dy vendeve, vendit të adhurimit dhe atij të mëkateve, e më afër cilit vend të jetë, atij vendi edhe i takon.

Melekët e matën hapësirën në mes dy vendeve.

Konstatuan se i penduari ishte më afër vendit që synonte (adhurimit).

Prandaj e morën Melekët e mëshirës.

Shkopi interesant

Një njeri nga beni israilët ia kërkoi një beni israilit tjetër 1000 dinarë.

Ai i thotë:

- Sillmi dy dëshmitarë le të dëshmojnë.

Ai i thotë:

- A mjafton që vetëm Allahu të jetë dëshmitar.

Ai i thotë:

- Sillma hipotekën.

Ai i thotë:

- Mjafton që Allahu të jetë garantues.

I thotë:

- Të vërtetën e the - dhe ia jep dinarët për një afat të caktuar.

Kaloi në anën tjetër të detit, *kreu punën me to*.

Kur erdh afati, kërkoi anije për t'ia çuar në afatin e caktuar, mirëpo anije nuk kishte. Atëherë e merr një dërrasë, e shpon dhe i fut brenda 1000 dinarë dhe letrën (të shkruar) prej filanit te filani. E mbylli mirë e tha:

- O Zoti im! Ti e di kur i kam marrë borxh prej filanit 1000 dinarë, i cili kërkoi garantim, e unë i thashë që garantues të jesh Ti o Zoti im, dhe ai u pajtua për këtë. Ai më kërkoi dëshmitarë, unë i thashë mjafton që dëshmitar të jesh Ti o Zoti im, dhe ai u pajtua me këtë. Mirëpo unë u mundova të gjej anije për t'ia larë borxhin, por nuk gjeta, për këtë arsye po i dorëzoj tek Ti - dhe e hodhi në det".

E përcolli deri sa u largua, dhe përfundimisht nuk gjeti anije.

Në anën tjetër, njeriu të cilit i kishte marrë borxh, shikon mos ka ardhur ndonjë anije duke pritur kthimin e borxhit.

Por, e sheh vetëm një shkop, në brendinë e të cilit ishte malli.

Duke tubuar dru për familjen e tij dhe duke i thyer (çarë drutë) i gjeti 1000 dinarët dhe letrën.

Pas një kohe vjen borxhmarrësi me 1000 dinarë tjera dhe i thotë:

- Për Zotin, pandërprerë kam kërkuar anije për të ardhur dhe për të t'i sjellë të hollat, mirëpo ishte e pamundur. Deri sa sot e takova një anije dhe erdha.

Ai i thotë:

- Vallë mos më ke dërguar mua diçka?

Tha:

- Të tregova se nuk kam mundur të gjej anije deri sot.

I tha:

- Zoti e ka la borxhin në vend tëndin, i cili e ka dërguar shkopin (me të holla). E ti me 1000 dinarët tjera vepro si të duash në rrugë të hajrit.

Dhënia e sadakasë hajnit

Një njeri kishte thënë:

- Do të jap sadaka.

Doli dhe e dha sadakanë në dorë të një hajni.

Të nesërmen të tjerët thoshin:

- Dje ky njeri i ka dhënë sadaka hajnit.

Ai tha në vetvete:

- O Zoti im!

Vetëm Ty të takon falënderimi!

Unë prapë do të jap sadaka.

Atij pastaj i paraqitet (në ëndërr) një zë duke i thënë:

- **Sadakaja e jote e dhënë hajnit, ndikoi që ai të largohet nga vjedhja.**

Dhënia e sadakasë të pandershmes

Një njeri kishte thënë:

- Do të jap sadaka.

Del nga shtëpia dhe i jep sadaka një të pandershmeje.

Të nesërmen njerëzit thoshin:

- Ky njeri i ka dhënë sadaka të pandershmes!

Ai thoshte në vetvete:

- O Zoti im! Vetëm Ty të takon falënderimi!

Unë prapë do të jap sadaka.

Atij pastaj i paraqitet (në ëndërr) një zë duke i thënë:

- **Sadakaja e jote e dhënë të pandershmes ndikoi që ajo të largohet nga pandershmëria.**

Dhënia e sadakasë të pasurit

Një njeri tha:

- Do të jap sadaka.

Del nga shtëpia dhe i jep sadaka një të pasuri.

Të nesërmen njerëzit thoshin:

- Ai i ka dhënë sadaka një të pasuri.

Ai thoshte në vetvete:

- O Zoti im!

Vetëm Ty të takon falënderimi, për atë që i kam dhënë sadaka të pasurit!

Atij pastaj i paraqitet (në ëndërr) një zë duke i thënë:

- **Sadakaja e jote e dhënë të pasurit ndikoi që ai të ketë në konsideratë dhe të shpenzojë (t'u japë të tjerëve) prej asaj çka i ka dhënë Allahu.**

Një njeri e bleu nga njëri një pronë të tokës.
Në atë pronë, më vonë gjen një qese me ari.
Shkon e i thotë pronarit të mëhershëm:
- Merre arin, se unë nga ti kam blerë tokën, e jo arin.

Pronari i tokës i thotë:
- Unë ta kam shitur tokën me tërë atë që është në të.

Shkuan te një njeri, gjykatës, për të gjykuar mes tyre.

Gjykatësi i tyre u thotë:
- A keni fëmijë?

Njëri thotë:
- Kam një djalë.

Tjetri thotë:
- Kam një vajzë.

Atëherë gjykatësi u thotë:
- Martoni fëmijët tuaj mes veti, pra djalin me vajzën,
dhe arin le ta trashëgojnë ata.

Dy gra (kunata) me fëmijët e tyre dalin në natyrë.

Aty një ujk e han njërin fëmijë.

Pastaj këto dy gra ngatërrohen në mes vete për fëmijën e mbetur, secila nga ato thoshte se fëmija i mbetur është fëmija i saj.

Shkojnë për t'u gjykuar te Davudi a.s.

Davudi a.s. gjykon që fëmija t'i takojë kunatës së madhe.

Ata prapë nuk pajtohen mes vete.

Shkojnë për t'u gjykuar te Sulejmani a.s.

Sulejmani a.s. u thotë:

- Më sillni një thikë që ta pres fëmijën për gjysmë dhe secilës prej jush t'jua jap nga një pjesë.

Kunata e vogël thotë:

- Po dëshiron ta presësh, o i Dërguar i Allahut?!

Sulejmani a.s. thotë:

- Po.

Atëherë i thotë (kunata e vogël):

- Mos e bëj këtë, sepse pjesën time do t'ia jap kunatës së madhe.

Atëherë Sulejmani a.s. i thotë:

- **Merre se ky fëmijë është i yti.**

Sulejmani a.s. e dinte se vetëm nëna e vërtetë pranon t'ia japë fëmijën tjetër kujt në mënyrë që fëmija të jetojë.

Prandaj Sulejmani gjykoi në dobi të saj.

Adhuruesi 500 vjeçar

Muhamedi a.s. tregon se si:

Një njeri e ka adhuruar Allahun 500 vjet pandërprerë.

Në maje të kodrës, ku gjerësia dhe gjatësia ka qenë tridhjetë nyje.

Në lartësi tridhjetë nyje.

Në mes të oqeanit, ku largësia prej toke ishte 4000 fersah nga çdo anë.

Pranë tij ishte një burim i ujit me madhësi të gishtit, i cili kishte ujë të ëmbël.

Ai burim ishte në rrënjë të vendit ku qëndronte.

Pranë tij ishte një shëgë, e cila jepte fruta të pjekura për çdo natë.

Gjatë ditës e adhuronte Allahun.

Kur bëhej natë, shkonte aty, merrte abdes dhe hante shëga.

E pastaj vazhdonte namazin dhe lutjet e tij.

Allahu ka dhënë urdhër që atij t'i merrej shpirti përderisa të jetë në sexhde, dhe që as toka e asgjë tjetër të mos ia prishin rrugën e tij, me qëllim që edhe në Ditën e Kijametit të ngrihet prej sexhdes.

Dhe ashtu ka ndodhur.

Muhamedi a.s. thotë: Dhe derisa ne shkonim lart e poshtë (Xhibrili) më tregoi:

- Ai do të ringjallet në Ditën e Kijametit dhe do të qëndrojë para Allahut.

Allahu do të thotë:

- Çojeni robin tim në xhenet me mëshirën Time.

Ai do të thotë:

- O Zoti im, me veprën time.

Allahu thotë:

- Çojeni robin tim në xhenet me mëshirën Time.

Ai thotë:

- O Zoti im, me veprën time.

Atëherë Zoti thotë: - Peshojani dhe krahasojani robin tim të mirat e Mia ndaj tij me veprat e tij.

Dhe vendoset (në peshojë) begatia e shikimit, e cila peshon me rëndë se 500 vjet adhurim,

ndërsa të gjitha të mirat e tjera trupore tepruan.

Pastaj thotë: - Kthejeni - dhe ai qëndron para Zotit.

Zoti thotë: - Kush të krijoi kur ishe asgjë?

Thotë: - Ti o Zoti im.

- Kush të ka forcuar në adhurim 500 vjet?

Thotë: - Ti o Zoti im.

Zoti i thotë: - Kush të vendosi në kodrën, ku në mes të saj buroi uji i ëmbël, e jo i njelmët, dhe për çdo natë piqeshin shëgat, përderisa ata piqen një herë në vit, dhe kam urdhëruar që shpirtin të ta marrin kur ti të jesh në sexhde dhe ashtu ndodhi?

Ai thotë: - Ti o Zoti im.

- Pra të gjitha kanë qenë me mëshirën Time. Prandaj edhe po të çoj në xhenet me mëshirën Time.

Çojeni robin tim në xhenet, sepse ka qenë robi Im i mirë - dhe vendoset në xhenet.

Kujdesi ndaj prindërve

Tre persona prej gjeneratave para jush janë nisur për një udhëtim.

Derisa i zë nata para një shpelle, në të cilën vendosen për ta kaluar natën.

Nga kodra rrokulliset një shkëmb dhe e bllokoi tërësisht hyrjen dhe daljen e shpellës.
(Ata duke biseduar mes vete) Thonë:

- Ne nuk mund të shpëtojmë gjallë nga kjo shpellë ndryshe, vetëm se duke i bërë lutje Allahut të Lartmadhëruar, në bazë të punëve tona të mira.

Personi i parë prej tyre lutet:

- O Zoti im! I kam pasur prindërit shume pleq.

Asnjëherë ujë nuk kam pirë para tyre.

Para tyre nuk i kam dhënë as familjes sime, po as punëtorëve të mi.

Një ditë u vonova për shkak të kërkimit të kullosës sa më të mirë, e kur u ktheva ata veç kishin fjetur.

Pasi e mola bagëtinë, qumështin ua dërgova atyre, por ata ishin fjetur.

Unë nuk desha t'ua prish gjumin atyre, por edhe nuk e kam pirë qumështin para tyre, e as nuk u dhashë të pinë familjes dhe punëtorëve të mi.

Qëndrova zgjuar në këmbë me qumështin në dorë duke i pritur deri sa të zgjoheshin.

Kështu prita deri sa agoi dita, e fëmijët e mi qanin për qumësht para këmbëve të mia, e unë u dhashë të pinë qumësht, tek atëherë, pasi u zgjuan prindërit e mi dhe pinë para tyre.

O Zoti im! Nëse këtë e kam bërë vetëm për të fituar kënaqësinë Tënde, na tejkaloni këtë fatkeqësi dhe lëvizni këtë shkëmb (e të dalim në dritë)!

Shkëmbi lëvizi, por jo edhe aq sa mund të dilnin jashtë.

Rëndësia e nderit

Tre persona prej gjeneratave para jush janë nisur për një udhëtim.

Derisa i zë nata para një shpelle në të cilën vendosen për ta kaluar natën.

Nga kodra rrokulliset një shkëmb dhe e bllokoi tërësisht hyrjen dhe daljen e shpellës. (Ata duke biseduar mes vete) Thonë:

- Ne nuk mund të shpëtojmë gjallë nga kjo shpellë ndryshe, vetëm se duke i bërë lutje Allahut të Lartmadhëruar në bazë të punëve tona të mira.

Njëri u lut:

- O Zoti im, kam pasur një kushërirë të afërm, të cilën e kam dashur më shumë se tërë botën, andaj kërkova prej saj (siç kërkojnë meshkujt prej femrave), por ajo më refuzoi.

Një vit prej viteve mbretëronte uri e madhe, e ajo u paraqiti tek unë.

E unë ia dhashë asaj 120 dinarë ari, me qëllim që të pranojë të vetmohej me mua.

Pasi i mori të hollat dhe e kisha në disponim (që të veproj me të çka të dua), ajo më tha:

- Frikësoju Allahut, e mos më çndero padrejtësisht!

Atëherë u largova prej saj dhe nuk kontaktova me të, edhe pse e doja më shumë se çdokënd tjetër, kurse të hollat të cilat ia pata dhënë, nuk ia mora.

- O Zoti im, nëse këtë e kam bërë vetëm për ta fituar Kënaqësinë tënde, na shpëto nga kjo vështirësi në të cilën gjendemi!

Shkëmbi prapë lëvizi (nga hyrja e shpellës), por jo në tërësi për të dalë nga aty.

Vlera e dhënies së borxhit

Tre persona prej gjeneratave para jush janë nisur për një udhëtim, deri sa i zë nata para një shpelle në të cilën vendosen për ta kaluar natën. Nga kodra rrokulliset një shkëmb dhe e bllokoi tërësisht hyrjen dhe daljen e shpellës. (Ata duke biseduar mes vete) Thonë:

- Ne nuk mund të shpëtojmë gjallë nga kjo shpellë ndryshe, vetëm se duke i bërë lutje Allahut të Lartmadhëruar në bazë të punëve tona të mira.

Personi i tretë u lut:

- O Zoti im, unë kam pasur punëtorë.

Të gjithëve ua kam dhënë pagën e fitimit menjëherë, përpos një punëtori, i cili ka shkuar pa e marrë pagën (e fundit). Pastaj pagën e tij e kam vendosur në qarkullim dhe pasuria e tij u shtua.

Pas një kohë me erdhi e më tha:

- O rob i Allahut, më jep pagën!

I thashë:

- Krejt çka sheh prej kësaj pasurie, si: këto dele, këto lopë, këto deve dhe ky rob, të gjithë janë shtuar prej pagës tënde.

Ai më tha:

- O rob i Allahut, mos u tall me mua!

Unë i thashë:

- Nuk jam duke u tallur me ty.

Pastaj e mori tërë pasurinë e tij dhe nuk la asgjë prej tyre.

O Zot im, këtë e kam bërë vetëm e vetëm për ta fituar kënaqësinë Tënde; na shpëto nga kjo fatkeqësi!

Atëherë shkëmbi lëvizi i tëri dhe që të tre dolën nga aty e shpëtuan.

Më digjni dhe me hidhni në det

Një njeri që asnjë të mirë nuk e ka pasur në jetën e tij,
i thotë familjes së tij:

- Kur të vdes ma digjni trupin, bëjeni hi,
pastaj hirin ndajeni në dy pjesë:
Njërën pjesë shpërndajeni në tokë,
pjesën tjetër shpërndajeni në det.

Këtë bëjeni se për Zotin, nëse Allahu ka caktuar që njerëzit të japin përgjegjësi për vepra,
do të jap llogari aq të madhe dhe do të dënohem aq shumë, aq sa asnjë njeri në botë
nuk është dënuar.

Kur vdiq, familja vepruan ashtu siç i kishte porositur.

Allahu e urdhëroi detin dhe e tuboi pjesën e tij.
Allahu e urdhëroi tokën dhe e tuboi pjesën e tij (Zoti e ngjalli atë).
Pastaj i tha:
- Përse veprove kështu?

Ai u përgjigj:
- O Zoti im, Ti e di më së miri, nga frika ndaj Teje.

Atëherë Allahu i Lartmadhëruar ia fali atij.

Një njeri duke udhëtuar në një rrugë.
E kaplon një etje e madhe.
E gjen një pus.
Zbret në të dhe pi ujë.

Pastaj del nga pusi.
E has një qen me gjuhë të nxjerrë jashtë, që ha baltë nga etja.

Njeriu thotë:
- Këtë qen e paska kapluar etja siç më pat kapluar edhe mua më parë.

Pastaj njeriu zbret në pus.
E mbush këpucën e vet me ujë.
Pastaj e kap me gojë derisa ngjitet lart dhe i jep të pijë qenit.

Allahu për këtë e shpërblen dhe ia fal mëkatet.

Një grua plakë ka shkuar te Pejgamberi a.s. dhe i ka thënë:

- O i Dërguar i Allahut.

Lute Allahun që të më shpjerë në Xhenet.

Pejgamberi a.s. i ka thënë:

- Por në Xhenet nuk hyjnë plakat!

Plaka u pikëllua.

Filloi të qajë.

Mendonte se kurrë nuk do të hyjë në xhenet.

Pejgamberi a.s. u tregoi sahabëve që të ja bëjnë me dije se nuk do të hyjë në Xhenet duke qenë plakë, por do ta shndërrojnë në vajzë të re, në gjendje të vajzërisë.

Këtë e tregon Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an:

- Dhe do t'i bëjmë ato virgjëresha.

Besimtari në varr

Kur të varroset i vdekuri besimtar i kthehet shpirti në trupin e tij,
i shkojnë dy melekë dhe e pyesin:

- Kush është Zoti yt?

Besimtari thotë:

- Allahu është Zoti im.

- Cila është feja jote?

- Feja ime është Islami.

- Cili peygamber është dërguar te ju?

- I Dërguari i Allahut - Muhamedi a.s.

- Cila është dituria (libri) juaj?

- Kam lexuar Kur'anin librin e Allahut, i kam besuar, vërtetuar dhe praktikuar në vepër.

Nga qielli vjen një thirrje:

- E ka thënë të vërtetën rob i im.

Shtroni shtrat të Xhenetit.

Visheni me rroba të Xhenetit.

Hapjani dyert e Xhenetit.

Nga brendia e shpirtit i vjen era e mirë,

i zgjerohet gjendja dhe i zgjatet shikimi.

I vjen një person me pamje të bukur, rroba të mira, erë të mirë e i thotë:

- Të përgëzoj me diçka të mirë, të përgëzoj me kënaqësinë e Allahut, Xhenetin me të mira të shumta dhe të përgjithshme dhe kjo është dita e premtuar.

Besimtari pyet:

- Ti që më përgëzon për të mira, kush je ti?

Thotë:

- Unë jam vepra jote.

Pastaj i hapet dera e Xhenetit dhe e sheh vendin e tij në Xhenet.

Pabesimtari në varr

Pabesimtari pasi të varroset i kthehet shpirti në trup,
i vijnë dy melekë dhe e pyesin:

- Kush është Zoti yt?

- Jo, nuk e di!?

- Cila është feja jote?

- Nuk e di!?

- Cili peygamber është i dërguar te ju?

- Nuk e di !?

Pastaj i thuhet:

- Nuk e dite, nuk ke njohuri për këto gjëra.

Vjen një zë nga qielli e thotë:

- Shtroni shtrat të Xhehenemit

Hapjani derën e Xhehenemit.

I vjen nxehtësi e fortë.

I shtrëngohet gjendja aq shumë saqë i pëlçasin edhe eshtrat.

I vjen një person me fytyrë të keqe.

Rroba të këqija.

Erë të keqe dhe i thotë:

- Kjo është dita e premtuar,

kjo është dita e ndëshkimit.

Jobesimtari i thotë:

- Kush je ti?

- Unë jam vepra e jote e keqe.

Pastaj verbërohet dhe shurdhohet.

Begatia në varr

Kur besimtari ndahet nga kjo botë dhe shkon në botën tjetër, atij nga qielli i zbresin melekë me fytyra të bardha, fytyrat e të cilëve shndrisin si dielli.

Me vete kanë rroba të bardha.

Erë të mirë të xhenetit, ulen në largësi prej tij sa sheh syri.

Pastaj i shkon meleku, i cili i merr shpirtrat, ulet te koka e tij dhe i thotë:

- O ti shpirt i mirë, dil se je i falur prej Allahut dhe ke fituar kënaqësinë e tij.

Pastaj i del shpirti sikurse del një pikë uji prej burimi dhe kur t'ia merr shpirtin ia merr me aq lehtësi saqë nuk hetohet.

Pastaj e marrin melekët.

E veshin me ato rroba.

E parfumojnë me erë të mirë.

Prej tij del shpirti si një frymëmarrje me erë misku të kësaj bote.

Ngrihen lartë me të dhe sa herë që kalojnë pranë një grupi të melekëve, ato pyesin:

- Po, çka është kjo erë e mirë?!

Ata i përgjigjen:

- Filani i biri i filanit, duke e emëruar me emrat më të bukur të tij, me të cilat e kanë thirrur në këtë botë; deri sa ta kalojnë qiellin e kësaj bote, në fillim të botës tjetër.

Aty kërkojnë t'u hapen dyert dhe ju hapet dera, e cila shndrit tërë qiellin paraprak, e deri te qielli i ardhshëm, e kështu me radhë, derisa arrijnë te qielli i shtatë, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

- Shkruajeni librin e robit tim në Ilijinë, dhe kthejeni prapë në tokë, se prej saj ju kemi krijuar, në të do t'ju rikthejmë.

Dënimi në varr

Pabesimtari kur të ndahet prej kësaj bote dhe shkon në botën tjetër.

I shkojnë melekët prej qielli me fytyrë të zezë.

Me rroba të zeza.

Ulen pranë tij në largësi sa sheh syri, pastaj i vjen meleku për t'ia marrë shpirtin, ulet te koka e tij.

I thotë:

- O ti shpirt i keq, dil se Allahu është i hidhëruar me ty.

I del shpirti prej trupit sikurse hekuri i zjarrtë kur flakërohet prej leshi, dhe ia merr shpirtin.

Çdo herë kur të kalojnë pranë ndonjë grupi të melekëve pyesin:

- Çka është kjo erë e keqe?

I përgjigjen:

- Filani i biri i filanit, pra me emrin me të cilin e kanë thirrur në këtë botë, derisa arrin në fund të qiellit të kësaj bote, kurse porta nuk hapet.

Pastaj i Dërguari i Allahut a.s. e lexoi ajetin kur'anor:

“... atyre nuk u hapen dyert e qiellit dhe nuk do të hyjnë në xhennet derisa të përbirojë deveja nëpër vrimën e gjilpërës...”.

Pastaj Allahu thotë:

- Shkruajeni në librin Sixhinë të tokës së thellë,

pastaj shpirti tronditet dhe thotë:

“... e kush i përshkruan shok Allahut, ai është sikur të bie nga qielli e ta rrëmbejë shpendi, ose si ai të cilin e gjuan era e stuhishme në ndonjë vend të humbur”.

Njeriu i fundit në xhenet

Në Ditën e Kijametit, Allahu e paraqet njeriun e fundit të umetit të Muhamedit a.s. para krijesave.

Pastaj i paraqet para tij nëntëdhjetë e nëntë fletushka (regjistra).

Secila nga fletushkat është në gjatësi sa sheh syri.

E i thotë:

- A mohon diçka prej këtyre?

Ai thotë:

- Jo o Zoti im.

Zoti i thotë: - Mos ndoshta regjistruarit e mi kanë shkruar gabim apo të kanë bërë ndonjë padrejtësi?

Ai thotë:

- Jo, Zoti im.

Zoti i thotë:

- A ke ndonjë arsyetim për këto (gabime) apo ndonjë vepër të mirë?

Ai thotë:

- Jo, Zoti im.

Allahu i Lartmadhëruar i thotë:

- Por ti te Ne ke një punë të mirë, e Ne nuk të bëjmë padrejtësi sot, dhe ia qet përpara vërtetimin (dokumentin) në të cilën është e shkruar **“Eshhedu en la ilahe il-lallah ve ene Muhamedun resulullah”**.

E pastaj thotë:

- Silleni peshojën (vagën) e tij.

Ai thotë:

- O Zoti im po çka është puna me këtë, si mund të matet ky dokument vërtetimi me të gjitha këto fletushka?!

Zoti i thotë: - Ty nuk të bëhet padrejtësi.

Në njërën anë të peshojës vendosen fletushkat

Në anën tjetër dëshmia e shahadetit.

Dëshmia e Shahadetit do të peshojë më rëndë, ndërsa fletushkat nuk peshojnë fare.

Asgjë nuk mund të matet me emrin e Allahut.

Melekët i vizitojnë ata të cilët e përkujtojnë Allahun

Zoti i Madhëruar dërgon melekë në tokë,
 për të kontrolluar rrugët dhe për t'i kërkuar ata të cilët e përkujtojnë Allahun.
 Kur ta takojnë popullin i cili e përkujton Allahun
 (u thuhet): - Kërkoni çka ju nevojitet - dhe i mbulojnë me krahët e tyre në qiell.
 Zoti i Madhëruar e di por prapë i pyet melekët:
 – Çka thonë robërit e mi?
Subhanallah,
Elhamdulilah,
Allahu ekber.

- A më kanë parë?
- Jo për Zotin nuk të kanë parë.
- Po si do të vepronin nëse më shohin?
- Sikur të të shohin:**
 - do të të adhuronin më shumë,
 - do të të falënderonin më shumë dhe
 - do të të lavdëronin më shumë.

Zoti në fund thotë:
 - Dëshmoj para juve se ua kam falur atyre gabimin.
 Njëri nga melekët thotë:
 - Në mesin e tyre është një njeri i cili ka ardhur për nevojë tjetër.
 Zoti i Madhëruar thotë:
 - **Ata janë një popull dhe të gjithë janë për një kuvendim.**

Melekët i vizitojnë ata të cilët e kërkojnë xhenetin

Zoti i Madhëruar dërgon melekë në tokë
për të kontrolluar rrugët dhe për t'i kërkuar ata të cilët e përkujtojnë Allahun.
Kur ta takojnë popullin i cili e përkujton Allahun
(u thuhet): - Kërkoni çka ju nevojitet - dhe i mbulojnë me krahët e tyre në qiell.
Zoti i Madhëruar e di por prapë i pyet melekët:
- Çka kërkojnë prej Meje?

- Kërkojnë Xhenetin.

- A e kanë parë atë?

- Jo, për Zotin nuk e kanë parë.

- Po sikur ta shihnin?

Sikur ta kishin parë:

- do ta lakmonin më shumë,

- do ta dëshironin më shumë dhe

- do ta kërkonin më shumë.

Zoti në fund thotë:

- Dëshmoj para juve se ua kam falur atyre gabimin.

Njëri nga melekët thotë:

- Në mesin e tyre është një njeri i cili ka ardhur për nevojë tjetër.

Zoti i Madhëruar thotë:

- Ata janë një popull dhe të gjithë janë për një kuvendim.

Melekët i vizitojnë ata të cilët kërkojnë mbrojtje nga xhehenemi

Zoti i Madhëruar dërgon melekë në tokë për të kontrolluar rrugët dhe për t'i kërkuar ata të cilët e përkujtojnë Allahun. Kur ta takojnë popullin i cili e përkujton Allahun (u thuhet): - Kërkoni çka ju nevojitet - dhe i mbulojnë me krahët e tyre në qiell. Zoti i Madhëruar e di por prapë i pyet melekët:

- Prej çka kërkojnë mbrojtje?
- Nga zjarri (Xhehenemit).

- A e kanë parë atë?
- Jo për Zotin nuk e kanë parë.

- Po sikur ta shihnin?

Sikur ta kishin parë:

- do të frikoheshin më shumë prej tij dhe
- do të largoheshin nga rruga e cila të shpie atje.

Zoti në fund thotë:

- Dëshmoj para juve se ua kam falur atyre gabimin.

Njëri nga melekët thotë:

- Në mesin e tyre është një njeri i cili ka ardhur për nevojë tjetër.

Zoti i Madhëruar thotë:

- Ata janë një popull dhe të gjithë janë për një kuvendim.

Muhamedi a.s i ka thënë Ibni Abasit:

O djalosh,

ruaji detyrat e tua ndaj Allahut,

ruaji detyrat e tua ndaj Allahut,

Kur të lutesh,

kur të mbështetesh,

Ai do të të ruaj ty;

Ai do të jetë me ty.

lutju Allahut;

mbështetu Allahut.

Ta dish se:

nëse i tërë populli tubohen për të ta bërë një punë të mirë ty,

nuk munden të bëjnë, pos atë çka e ka shkruar Allahu për ty.

Po nëse tubohen për të ta bërë një të keqe,

nuk munden të të dëmtojnë, pos atë dëmtim çka e ka shkruar Allahu për ty.

Lapsat janë ngritur dhe fletët e librit janë tharë.

IMANI	7
ISLAMI	8
IHSANI	9
MELEKU DHE I ZGJEBOSURI	10
MELEKU DHE TULLACI	11
MELEKU DHE I VERBËRI.....	12
FOSHËNJA NË DJEP	13
FLOKTARJA E BIJËS SË FIRAUNIT	14
PENDIMI PAS 100 VRASJEVE	15
SHKOPI INTERESANT	16
DHËNIA E SADAKASË HAJNIT	17
DHËNIA E SADAKASË TË PANDERSHMES.....	18
DHËNIA E SADAKASË TË PASURIT	19
GJYKIMI I DREJTË	20
NËNA	21
ADHURUESI 500 VJEÇAR	22
KUJDESI NDAJ PRINDËRVE	23
RËNDËSIA E NDERIT	24
VLERA E DHËNIES SË BORXHIT	25
MË DIGJINI DHE ME HIDHNI NË DET	26
QENI I ETUR	27
MAHIA E VËRTETË.....	28
BESIMTARI NË VARR	29
PABESIMTARI NË VARR.....	30
BEGATIA NË VARR.....	31
DËNIMI NË VARR	32
NJERIU I FUNDIT NË XHENET	33
MELEKËT I VIZITOJNË ATA TË CILËT E PËRKUJTOJNË ALLAHUN.....	34
MELEKËT I VIZITOJNË ATA TË CILËT E KËRKOJNË XHENETIN	35
MELEKËT I VIZITOJNË ATA TË CILËT KËRKOJNË MBROJTJE NGA XHEHENEMI	36
KËSHILLAT E MUHAMEDIT A.S. DHËNË IBN ABASIT	37